



Mali i Zi / Crna Gora
Komuna e Tuzit / Opština Tuzi

Sekretariati për vetëqeverisje lokale
Sekretariatit za lokalnu samoupravu

Nr./Br. 04-100/26-6298/2



Rruga Tuz nr. 1 , nr. 44
Ulica Tuzi br.1 , br. 44

+382 20 875 167
veteqeverisje.lokale@tuzi.org.me
Tuz – Tuzi, 05.08.2026. godine

Në bazë të nenit 113 paragrafit 1 dhe 3 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale ("Fleta Zyrtare e MZ", nr. 02/18, 34/19, 38/20, 50/22, 84/22, 081/25, 098/25), e në lidhje me nenin 5 të Vendimit mbi organizimin mbi mënyrën e punës së administratës lokale të Komunës së Tuzit ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale", nr. 022/23, 024/23, 029/24, 032/24, 012/25, 007/26) dhe Vendimit mbi fillimin e procedurave për plotësimin e vendit të punës, numër 01-100/26-6298/1 prej më 31.07.2026, Sekretariati për vetëqeverisje lokale - Zyra për burimet njerëzore, shpall:

SHAPLLJE PUBLIKE

për nevojat e Shërbimit të mbrojtjes dhe shpëtimit të Komunës së Tuzit

1. Zjarrfikës /e - Shpëtimtar /e - shofer - i Shërbimit të mbrojtjes dhe shpëtimit

- Ekzekutues: 1, në kohë të pacaktuar;
- arsim i mesëm të paktën niveli III i kualifikimit arsimor;
- të paktën një vit përvojë pune;
- provim profesional të dhënë për punë në organe shtetërore; provimin e dytë profesional të dhënë për punë në organe shtetërore në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit;
- të përmbush kërkesën në lidhje me aftësinë psikofizike;
- patentë shoferi e kategorisë „C”
- njohuri të gjuhës shqipe;
- jo më i vjetër se 25 vjeç, në kohën e punësimit të parë.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- formulari i paraqitjes për vendin e lire të punës (Formularin e paraqitjes për vendin e lirë të punës kandidatët mund ta nxjerrin në web faqen e Komunës së Tuzit www.tuzi.org.me ose drejtpërdrejt në arkivin e Komunës së Tuzit);
- Curriculum Vitae – CV;
- fotokopja e letërnjoftimit biometrik e vërtetuar;
- diplomë ose vërtetim mbi përfundimin e nivelit dhe llojit të arsimit të vërtetuar;
- vërtetimin se nuk është denuar për vepër penale që e bën të papërshtatshëm për të punua në organet shtetërore, e siguron organi sipas detyrës zyrtare;
- dëshmi (vërtetim/miratim) mbi përvojën e kërkuar të punës të vërtetuar;
- vërtetim mbi provimin e dhënë profesional për punë në organet shtetërore të vërtetuar;
- certifikatë e vërtetuar për dhënien e provimit të dytë profesional për punë në organet shtetërore në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit;
- patentë shoferi e kategorisë „C” e vërtetuar

Periudha e provës në punë është e obligueshme për zyrtarin shtetërorë i cili për herë të parë lidh marrëdhënie pune në kohëzgjatje të pacaktuar në organin shtetërorë. Periudha e provës zgjatë një vit.

Kandidatët janë të detyruar që Zyrës për burime njerëzore (në tekstin e mëtejme: Zyrja) t'i dorëzojnë me formularin e paraqitjes origjinal dokumentacionin ose fotokopjet e vërtetuara të dokumentacionit.

Me organin shtetëror nuk mund të lidh vend pune personi i cili është përdorues i të drejtës në pension, në pajtim me ligjin.

Zyrtari shtetëror, gjegjësisht nëpunësi i cili e ka realizuar të drejtën në paketën për shkurtim nga puna nuk mund të lidhin vendin e punës në organin shtetëror ose personin juridik, në periudhën prej një viti nga dita e pagesës së paketës për shkurtim nga puna. Kufizimi nuk vlen për personin i cili e kthen shumën totale të paketës për shkurtimin e punës që ka pranuar.

Verifikimi i njohurive, aftësive, kompetencave dhe shkathtësisë, varësisht prej kategorisë së vendit të punës do të kryhet në përputhje me nenin 115 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale ("Fleta zyrtare e Malit të Zi", nr. 02/18, 034/19, 38/20, 050/22, 084/22, 081/25, 098/25), si dhe nenet 6-17 të Rregullores mbi kriteret dhe metodën e detajuar të kryerjes së verifikimit të njohurive, aftësive, kompetencave dhe shkathtësisë për punë në organet shtetërore, ("Fleta zyrtare e Malit të Zi", Nr. 088/25).

Testimi me shkrim përfshin hartimin e testit të përgjithshëm dhe zgjidhjen e detyrës praktike.

Testi i përgjithshëm dhe detyra praktike hartohen në formë elektronike, nën kod.

Për testin e përgjithshëm, Zyra për burime njerëzore përgatit një listë pyetjesh që kanë të bëjnë me verifikimin e kompetencave të përgjithshme si më poshtë: aftësia analitike në punë, komunikimi me shkrim, shkathtësitë digjitale, orientimi drejt rezultateve të punës.

Përmbajtja e testit të përgjithshëm përcaktohet me metodën e përzgjedhjes së rastësishme të 60 pyetjeve, në të cilat kandidati përgjigjet duke zgjedhur një nga disa përgjigje të ofruara.

Kandidati që arrin së paku tetë (8) pikë në testin e përgjithshëm për secilën kompetencë veç e veç, mund t'i nënshtrohet zgjidhjes së detyrës praktike.

Detyra praktike përfshin zgjidhjen e një detyre që ka të bëjë me verifikimin e kompetencave specifike.

Përmbajtja e detyrës praktike përcaktohet në varësi të kategorisë së vendit të punës dhe nivelit përkatës brenda asaj kategorie për të cilën zhvillohet procedura e verifikimit, si dhe në varësi të specifikave të detyrave që kryhen në pozitën përkatëse.

Kohëzgjatja e zgjidhjes së detyrës praktike është jo më shumë se 60 minuta.

Kandidati që arrin më shumë se 50% të pikëve në detyrën praktike, përkatësisht kandidati që vlerësohet me notën "plotëson kërkesat", mund t'i nënshtrohet intervistës me gojë.

Gjatë intervistës me gojë, secilit kandidat i parashtrohen të njëjtat pyetje sipas të njëjtit renditje, me ç'rast mund të parashtrohen edhe pyetje shtesë dhe të kërkohen sqarime plotësuese.

Kohëzgjatjen e intervistës me gojë e përcakton komisioni dhe ajo duhet të jetë e njëjtë për të gjithë kandidatët.

Verifikimi i dijes së daktilografisë, informatikës ose gjuhës së huaj bëhet në pajtim me rregullat, gjegjësisht standardet në këto fusha.

Mbi datën, vendin, dhe mënyrën e verifikimit, të kandidatëve nga lista, kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e shpalljes publike do të jenë të njoftuar përmes ueb faqes së Komunes së Tuzit, më së largu pesë ditë para ditës së verifikimit.

Dokumentacioni i kërkuar është i nevojshëm të dorëzohet në afat prej 15 ditëve nga dita e shpalljes së konkursit publik në zarf të mbyllur (në të cilin është e nevojshme të shkruhet: emri dhe mbiemri, adresa, kontakt telefoni, emri i organit dhe vendi i punës) në adresën:

Komuna e Tuzit

Sekretariati për vetëqeverisje lokale - Zyra për burime njerëzore

Me shënim: për Shpallje publike për nevoja të Shërbimit të mbrojtjes dhe shpëtimit të Komunes së Tuzit

Kontakt tel: +38220875167;

